



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.701/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Arton Musliu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** si i bazuar apeli i Arton Musliu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Viti.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Viti, në Vendvotimet: 2617D/01R 2617D/02R, 2617D/03R, 2617D/04R, 2620D/01R, 2620D/02R, 2620D/03D, 2601D/03R, 2601D/01R, 2601D/02R, 2601D/04R, 2601D/05D, 2601X/01R, 2601X/02R, 2601X/03R, 2601X/05D, 2604D/01R, 2604D/02R, 2604D/03R, 2604D/03D, 2605D/01R, 2605D/03R, 2605D/04R, 2605D/05D, 2607D/01R, 2607D/02R, 2608D/01R, 2608D/02R, 2612D/01D, 2621D/01R, 2621D/02R, 2621D/03R, 2630D/01R, 2630D/02R, 2631D/01R, 2632D/01R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e votimit, në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 09.11.2017 në ora 15:05, e Arton Musliu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega Viti, ku pretendon se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave në këto qendra të votimit: 2612d/01R në fshatin Buzovik nga 47 vota gjithsej ka marr subjektin politik PDK, 43 vota janë bartur vetëm tek një kandidat i po të njëjtit subjekt politik, në QV 2608d vendvotimi (VV) 01R në Shkollën Fillore “Nazmi Pajaziti” fshati Radivojc nuk posedon asnjë vote, edhe pse ka pasur votues në këtë QV, në QV2617d në fshatin Smire VV 0Rr, 02R, 03R, dhe 04R po ashtu ka pasur parregullsi të rezultatit, në QV 2617d, VV 01R dhe 03R i mungojnë votat, QV 2620d/01R, 2620d/02R dhe 2620d/03D 02R i mungojnë votat, gjithsej 5 vota, 2601d/03R i posedon 3 vota kurse pretendon se ka 8 vota, në QV 2601d/01R i posedon vetëm 2 vota, ndërsa pretendon ti ketë

ka 10 vota, në QV 2601d/02R ka vetëm 3 vota pretendon ti ketë 12 vota, në QV 2601d/04R ka vetëm 2 vota pretendon ti ketë 5 vota, në VV 2601d/05d ka vetëm 1 votë ndërsa pretendon se i posedon 3 vota, QV 2601x/01R, ka 3 vota ndërsa pretendon ti ketë 4 vota, në QV 2601x/02R posedon 2 vota pretendon ti ketë 6 vota, në QV 2601x/03R posedon 0 vota, ndërsa pretendon të ketë më shumë, në QV 2601x/05d ka vetëm 1 votë, pretendon ti ketë 4 vota, në QV 2604d/01R 1 votë, në QV 2604d/02R 0 vota, në QV 2604d/03d 0 vota, në QV 2605d/01R 0 vota, QV 2605d/03R 0 vota, QV 2605D/04R 4 vota, QV 2605D/05d 2vota, QV 2607d/01R 1 votë, QV 2608d/01R 0 vota, QV 2608d/02R 0 vota, QV 2612d/01d 1 votë, QV 2617d/01d 1 votë, QV 2617d/01R 1 votë, 2617d/02R 0 vota, QV 2617d/03R 1 votë, QV2617d/04R 1 votë, QV 2621d/01R 2 vota, 2621d/02R 0 vota dhe 2621d/03R 0 vota, QV 2630d/01R 0 vota, QV 2630d/02R 1votë, QV 2631d/01R 1 votë dhe QV 2632d/01R 1 votë. Me propozim qe Fletëvotimet qe janë ne kutit e votimeve ne vendvotimet e lartpërmendura te rinumërohen.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

#### **Apeli është i bazuar.**

Paneli gjeti se pretendimet ne apel janë të bazuara për faktin se pas shqyrtimit te provave dhe shkresave të lëndës, Paneli ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit. Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i e urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimet e cekura ne pjesën II te dispozitivit te vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura Paneli vendosi si në dispozitiv te vendimit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësishtë e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha me sipër bazuar ne nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr.701/2017 më datën 12.11.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Zyheri Hazri**



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.